



Under the auspices of
the Secretary General of
the Council of Europe,
Mr Thorbjørn Jagland



European Rural Community Alliance PREPARE Partnership for Rural Europe
European LEADER Association for Rural Development

Press Release
For immediate use

7 November 2015

E gjithë Europa do të jetojë!
Popullsia rurale e Europës kërkojnë të drejtat e tyre

Një mbledhje e 240 njerëzve që përfaqësojnë komunitetet rurale nga 40 shtete të Europës, u takuan në Parlamentin e dytë Rural European dhe, miratoi një Manifest Rural European ambicioz. Aty u bë thirrje për njohje të plotë të së drejtës së komuniteteve rurale për cilësinë e jetës dhe që standardi i jetesës të jetë i barabartë me atë të popullsisë urbane, si dhe të ketë pjesëmarrje të plotë në proceset politike.

Ky Manifest, i cili po angazhohet për veprime në 30 çështje kyçe, që kanë rezultuar nga fushatat kombëtare në 40 shtete, duke përfshirë mijëra banorë ruralë.

Ata bënë thirrje për partneritet të rifreskuar dhe të barabartë ndërmjet popullsisë rurale dhe qeverive. Ata e pranuan se popullsia rurale ka përgjegjësi për të vepruar në drejtim të mirëqenies së tyre, por kërkuan nga qeveritë në të gjitha nivelet, përfshirë edhe institucionet europiane, të punojnë që ta bëjnë sa më të efektshëm këtë partneritet të rëndësishëm.

Parlamenti Rural European i bëri thirrje Bashkimit European për të filluar një shqyrtim të përgjithshëm të gjendjes në zonat rurale brenda BE-së. Konkluzionet nga ky rishikim duhet të pasqyrohen në fokus të zgjeruar në zonat rurale në kuadër të të gjitha programeve dhe fondeve përkatëse të BE-së. Fushata e Parlamentit Rural European do të vazhdojë gjatë dy viteve të ardhshme me qëllim për të ndikuar në përgatitjen e politikave për periudhën pas vitit 2020.

Pjesëarrësit në Parlamentin Rural European ishin mëse të vetëdijshëm se qyteti Schärading, në të cilin është mbajtur takimi, është duke pranuar nga 2000 refugjatë në ditë në rrugën e tyre përgjatë kufirit në mes të Austrisë dhe Gjermanisë. Për shumë zona rurale kjo ofron një mundësi për integrimin e refugjatëve dhe të porsaardhurve të tjerë, duke pasur parasysh krijimin e nevojshëm të vendeve të punës, investimet në strehim, shërbime të tjera dhe infrastrukturë. Parlamenti Rural European bëri thirrje për mikpritje të përzemërt, të bazuar në solidaritetin midis popujve.

Organizatorët e Parlamentit Rural European do të vazhdojnë të mundësojnë veprimet e përmendura në manifest, në bashkëpunim me partnerët, qeveritë dhe institucionet kombëtare dhe europiane.

Shënime për Redaktorë

1. Një kopje e Manifestit Rural, i debatuar dhe i pranuar nga të gjithë pjesëmarrësit në Parlamentin Rural Europian, është e bashkangjitur. Ky ishte rezultat i fushatave kombëtare në 40 shtete duke identifikuar çështjet më të rëndësishme për popullsinë të Europës.
2. Parlamenti Rural Europian është nismë e përbashkët nga tri rrjete rurale Pan-europiane - European Rural Community Alliance (ERCA); PREPARE Partnership for Rural Europe; dhe European LEADER Association for Rural Development (ELARD). Anëtarët e këtyre rrjeteve gjenden kudo në shtetet e BE-së, Ballkanit Perëndimor dhe të Detit të Zi.
3. Fushata ERP është nën patronazhin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, z. Thorbjørn Jagland; dhe është bashkë-financuar nga Komisioni Europian për programin për Qytetarë.
4. Takimi ERP 2015 u mbajt në qytetin e bukur të vogël Schärding në Austrinë e Epërme. Bartës të takimit kanë qenë Sauwald-Pramtal Grupi Lokal i Veprimit (Local Action Group) dhe Këshilli i Qytetit Schärding (Town Council), organizuar nga kompania Projects4, dhe të ndihmuar me grante nga qeveria e Austrisë dhe qeveria e Austrisë së Epërme.
5. Në këtë Takim morën pjesë qytetarë nga komunitetet rurale nga pothuajse të gjitha shtetet e BE-së, si dhe nga Shqipëria, Armenia, Bellorusia, Bosnja dhe Herzegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kosova, Islanda, Norvegjia Serbia, Turqia dhe Ukraina.
6. Më shumë informata mund të gjenden në www.europeanruralparliament.com

Kontaktet

Joint Coordinators, European Rural Parliament 2015

Michael Dower (PREPARE) *Tel +44 1308 863515, e-mail: mdower6@btinternet.com*

Vanessa Halhead (ERCA) *Tel+44 1381600736 M. +44 7753834910, e-mail: vanessa@duthchas.org.uk*

PROJECTS4 (Organisers in Austria)

Thomas Müller *Tel +43.664.2214269, e-mail mueller@projects4.info*



Co-funded by the
Europe for Citizens Programme
of the European Union

